

# VLERËSIMI I KOMUNITETIT PËR QEVERISJEN

RAPORT BASHKIA KUÇOVE



# **RAPORT**

## **VLERËSIMI I KOMUNITETIT PËR QEVERISJEN 2016**

### **BASHKIA KUÇOVË**

## **SHËNIM I RËNDËSISHËM**

Ky raport u përgatit me:

Mbështetjen financiare dhe teknike të Agjencisë për Zhvillim Ndërkombëtar të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (USAID). Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillimin Ndërkombëtar ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

Dhe me

Mbështetjen financiare dhe teknike të Njesisë së Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave (UN Women), në kuadër të programit “Lidershipi dhe Pjesëmarrja Politike”. Ky program është financuar nga Qeveria Suedeze nëpërmjet Fondit të Koherencës së Kombeve të Bashkuara dhe është pjesë e “Programit të Bashkëpunimit ndërmjet Qeverisë së Shqipërisë dhe Kombeve të Bashkuara 2012-2016”. Mendimet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë raport janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht mendimet e UN Women, të Agjencive të Kombeve të Bashkuara apo të Qeverisë Suedeze.

## **AUTORËT**

Raporti u përgatit dhe u hartua nga ekspertët e Qendrës Aleanca Gjinore për Zhvillim me mbështetjen dhe asistencën e:

Laureta MEMO, Eksperte për Angazhimin Qytetar dhe Komunikimin, USAID/Projekti i Planifikimit dhe Qeverisjes Vendore

Fiorela SHALSI, Menaxhere e Programit Kombëtar “Lidershipi dhe Pjesëmarrja në Politikë”, UN Women

Të drejtat e publikimit

© Aplikimet për lejen për të riprodhuar ose përkthyer të gjithë ose një pjesë të këtij studimi duhet bërë në zyrën e GADC-së me adresë:

Rr. Abdyl Frashëri”, P.10/1, shk.1, ap.3

E-Mail: [gadc@gadc.org.al](mailto:gadc@gadc.org.al)

[www.gadc.org.al](http://www.gadc.org.al)

# TABELA E PËRMBAJTJES

<b>MIRËNJOHJE</b> .....	<b>5</b>
<b>SHKURTIME</b> .....	<b>6</b>
<b>1. HYRJE</b> .....	<b>7</b>
<b>2. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b> .....	<b>8</b>
<b>3. PROFILI I BASHKISË KUÇOVË</b> .....	<b>9</b>
<b>4. METODOLOGJIA</b> .....	<b>11</b>
<b>5. PËRSHKRIM I PROJEKTIT</b> .....	<b>13</b>
<b>6. PËRMBLEDHJE E REZULTATEVE</b> .....	<b>15</b>
<b>7. GJETJET KRYESORE</b> .....	<b>17</b>
7.1.1 Shërbimet Publike – Cilësia dhe Efiçenca .....	17
7.1.2 Demokracia Vendore dhe Mirëqeverisja .....	18
7.1.3 Zhvillimi Ekonomik Vendor .....	18
7.1.4 Të drejtat e njeriut në nivel lokal.....	19
<b>8. KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME</b> .....	<b>20</b>
8.1 KONKLUSIONE PËR QYTETIN .....	20
8.1.1 Shërbimet Publike – Cilësia dhe Efiçenca .....	20
8.1.2 Demokracia dhe Mirëqeverisja .....	21
8.1.3 Zhvillimi Ekonomik Vendor.....	22
8.1.4 Të Drejtat e Njeriut në Nivel Lokal .....	23
8.2 KONKLUSIONE PËR NJËSITË ADMINISTRATIVE .....	24
8.2.1 Cilësia dhe Efiçenca e Shërbimeve Publike .....	24
8.2.2 Demokracia dhe Mirëqeverisja .....	25
8.2.3 Zhvillimi Ekonomik Vendor.....	25
8.2.4 Të Drejtat e Njeriut në Nivel Lokal .....	26
8.3 REKOMANDIME.....	26
<b>RRETH QENDRËS ALEANCA GJINORE PËR ZHVILLIM</b> .....	<b>29</b>

# MIRËNJOHJE

Me mirënjohje falënderojmë të gjithë ata që ndihmuan në realizimin e këtij raporti për të vlerësuar qeverisjen vendore dhe gjithë qytetarët e Bashkisë Kuçovë, të cilët morën pjesë aktive në aktivitet e realizuara përmes projektit dhe përmes argumenteve vlerësuan mirëqeverisjen lokale për bashkinë e tyre.

Një falënderim i veçantë i dedikohet z. Selfo Kapllani dhe stafit të tij të cilët morën angazhime konkrete përballë qytetarëve bazuar në sugjerimet e tyre për përmirësimin e punës në Bashkinë e Kuçovës. Gjithashtu, falënderimi i shkon edhe Komisionit Këshillimor Qytetar Vendor Kuçovë për angazhimin vullnetar në këtë proces dhe jo vetëm.

Një falënderim shkon edhe për mbështetësit dhe financuesit e këtij projekti, Programit të Kombeve të Bashkuara për Gratë në Shqipëri, UN Women dhe Projektit të USAID për Planifikimin dhe Qeverisjen Vendore (PLGP) për mbështetjen financiare dhe teknike gjatë zbatimit të projektit.

# SHKURTIME

DAR	Drejtoria Arsimore Rajonale
NJQV	Njësi të Qeverisjes Vendore
KKQV	Komisioni Këshillimor Qytetar Vendor
PAK	Personat me Aftësi të Kufizuara
PLGP/USAID	Projekti i USAID për Planifikimin dhe Qeverisjen Vendore
QAGJZH	Qendra “Aleanca Gjimore për Zhvillim”
RAT	Reforma Administrative-Territoriale
VKQ	Vlerësimi i Komunitetit për Qeverisjen
UN Women	Programi i Kombeve të Bashkuara për Gratë
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar

# 1. HYRJE

Ndërkohë që po bëhet progres për avancimin e procesit të decentralizimit në Shqipëri, sfidat për zbatimin me sukses të qeverisjes vendore të decentralizuar e demokratike janë të mëdha. Reforma Administrative-Territoriale (RAT) që filloi të zbatohet në qershor të vitit 2015, pati ndikim të konsiderueshëm në funksionimin dhe administrimin e njësive të qeverisjes vendore (NJQV). Zvogëlimi i numrit të NJQV-ve nga 373 në 61, çoi rrjedhimisht në rritjen ndjeshëm të territorit, popullsisë dhe kompleksitetit të funksionimit të tyre. Ndikimi i reformës është i madh, jo vetëm në aspektin e përgjegjësive dhe funksioneve të shtuara të njësive vendore, por edhe në ofrimin e shërbimeve me cilësi dhe efikasitet për qytetarët e bashkisë së zgjeruar tashmë. Paralelisht me këtë, bashkitë tani përballen me sfida edhe më të mëdha se më parë për të arritur informimin, përfshirjen dhe përfaqësimin e vërtetë të grave dhe burrave në vendimmarrje.

Në këtë kuadër, që prej vitit 2015, Projekti i USAID për Planifikimin dhe Qeverisjen Vendore (PLGP) dhe UN Women, në bashkëpunim me organizata të shoqërisë civile dhe Komisionet Këshillimore Qytetare Vendore (KKQV) kanë ndërmarrë projektin e Vlerësimit të Komunitetit për Qeverisjen (VKQ) në 10 nga bashkitë më të mëdha në vend. Në pritje të reformës dhe zgjedhjeve vendore të vitit 2015, VKQ u zbatua në bashkitë e Elbasanit, Beratit, Kamzës dhe Vlorës, ku gjetjet dhe rekomandimet e qytetarëve gra dhe burra u prezantuan dhe u përfshinë në axhendat dhe programet e kandidatëve për kryetarë bashkie. Këtë vit, VKQ u zbatua në gjashtë bashki të reja: Fier, Gjirokastrë, Kuçovë, Kuçovë, Lushnjë dhe Shkodër. Vlerësimi i Komunitetit për Qeverisjen përfshin aspekte kryesore të qeverisjes vendore, të tilla si: (I) cilësia dhe efikasiteti i shërbimeve publike; (II) qeverisja e mirë dhe demokracia lokale; (III) zhvillimi ekonomik dhe (IV) të drejtat e njeriut në nivel vendor.

Përmes vjeljes së opinioneve të qytetarëve në identifikimin dhe përcaktimin e prioritetëve lokale, VKQ synon të krijojë dhe promovojë mekanizma qytetare në funksion të përmirësimit të demokracisë lokale. Procesi i VKQ mundëson monitorimin dhe vlerësimin e performancës së administratës lokale, paralelisht me ndërtimin e urave të dialogut, ndërveprimit dhe bashkëpunimit në nivel vendor.

Vlerësimi i komunitetit për qeverisjen është një qasje dhe mundësi e mirë që bashkitë të kuptojnë nevojat dhe përparësitë e qytetarëve. Harmonizimi dhe përfshirja e rezultateve të vlerësimit të komunitetit në programet vendore, si dhe përpjekja për të influencuar në hartimin e politikave vendore, janë një tregues pozitiv i demokracisë në veprim. Kombinimi i metodologjisë së VKQ me aktorë kyç lokalë, të tillë si Komisionet Këshillimore Qytetare dhe organizata të shoqërisë civile kanë mundësuar zbatimin me sukses të këtij procesi.

## 2. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Informacioni i përfshirë në këtë raport prezanton ecurinë e procesit të Vlerësimit të Komunitetit për Qeverisjen në Bashkinë Kuçovë në periudhën qershor-nëntor 2016 dhe përfshin vlerësimin nga ana e komunitetit dhe administratës vendore të performancës së shërbimeve të ofruara në nivel vendor, si dhe gjetjet dhe rekomandimet e ardhura nga qytetarët. Procesi i VKQ-së i ofron Bashkisë Kuçovë një tablo të qartë të vlerësimit të qytetarëve në lidhje me shërbimet publike, zhvillimin ekonomik, funksionimin e demokracisë vendore dhe të drejtat e njeriut në nivel lokal.

Procesi i Vlerësimit të Komunitetit për Qeverisjen u realizua nga Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim (QAGJZH) në bashkëpunim me Bashkinë Kuçovë, njësitë administrative Kozarë dhe Perondi, me pjesëmarrjen e Komisionit Këshillimor Qytetar Vendor Kuçovë dhe komunitetit në njësitë administrative të sipërpërmendura.

Projekti Vlerësimi i Komunitetit për Qeverisjen u shtri në harkun kohor qershor-nëntor 2016 dhe përfshiu 10 bashki, ndër të cilat edhe Bashkinë Kuçovë. Qëllimi i këtij projekti është përmirësimi i demokracisë vendore përmes fuqizimit të mekanizmave qytetarë. Objektiva specifike të tij synojnë të nxisin ndërveprimin dhe dialogun mes qytetarëve dhe autoriteteve vendore, përmes përfshirjes së prioritetëve dhe nevojave të qytetarëve në programet dhe buxhetet vendore, duke krijuar kushte për përmirësim të qëndrueshme të shërbimeve që i ofrohen komunitetit dhe duke fuqizuar në këtë mënyrë bashkëpunimin midis të dyja palëve.

Për realizimin e VKQ u punua ngushtësisht me administratën e bashkisë për të siguruar gatishmërinë dhe bashkëpunimin e tyre në proces, gjë që kërkoi takime dhe diskutime paraprake në lidhje me metodologjinë, fushat që trajtonte VKQ, zonat e përzgjedhura për zbatim dhe pjesëmarrjen qytetare në të. Në bashkërendim me Bashkinë, zonat e zgjedhura për të realizuar VKQ ishin njësitë administrative Kuçovë, Kozarë dhe Perondi. Vlen për t'u theksuar kontributi i çmuar i Komisionit Këshillimor Qytetar.

Gjatë procesit të përpunimit të vlerësimeve janë konsultuar gjerësisht materiale, dokumente dhe strategji, të tilla si: Draft Strategjia e Zhvillimit të Territorit, buxheti i Bashkisë Kuçovë për vitin 2016, Plani i Punës së Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2015-2020, Ligji 119/2014 Për të drejtën e Informimit, Ligji 135/2015 për Organizimin dhe Funksionimin e Vetëqeverisjes Vendore, faqja e internetit e Bashkisë, etj.

Në këtë raport do të lexoni: 1) Një profil të shkurtër të Bashkisë Kuçovë; 2) Metodologjinë e projektit; 3) Përshkrimin e projektit; 4) Përmbledhjen e rezultateve të vlerësimit të qytetarëve korçarë për qeverisjen vendore; 5) Gjetje e rekomandime për të ardhmen.



# 3. PROFILI I BASHKISË KUÇOVË

*Informacioni i përdorur për përgatitjen e këtij profili është nxjerrë nga draft Strategjia e Zhvillimit të Territorit të Bashkisë Kuçovë.*

Pas Reformës Administrative-Territoriale, Bashkia Kuçovë përbëhet nga 4 njësi administrative, të cilat janë: Kuçovë, Kozar, Perondi dhe Lumas. Kryeqendra e bashkisë është qyteti i Kuçovës. Ajo ka nën administrimin e saj një qytet dhe 31 fshatra. Bashkia ka një sipërfaqe prej 160.23 km katror. Sipas Censusit të vitit 2011, kjo bashki numëron 31.262 banorë, ndërsa sipas Regjistrimit Civil ajo numëron një popullsi prej 55.293 banorë. Bashkia Kuçovë kufizohet në veri dhe perëndim me bashkinë Belsh, në lindje me bashkinë Gramsh, në jug me bashkinë Berat dhe në perëndim me bashkinë Ura Vajgurore.

Qyteti i Kuçovës, ish-qyteti naftëtar Stalin, i bashkuar me tre njësitë administrative kombinon tashmë resurset e tij deri më tash të bazuara kryesisht tek nafta, me sektorin bujqësor të këtyre zonave rurale. Burimi kryesor i Kuçovës vazhdon të mbetet nafta dhe gazi, zbuluar dhe shfrytëzuar hershëm në këtë zonë. Pasuria natyrorë e naftës dhe gazit në këtë zonë, vazhdon të konsiderohet ende e lartë, por jo e shfrytëzuar sa duhet si pasojë e mungesës së investimeve në këtë fushë. Njësitë administrative Perondi dhe Kozarë, karakterizohen nga toka fushore, ku të ardhurat sigurohen përmes prodhimit të arave dhe perimeve, ku vitet e fundit janë ngritur dhe një numër i konsiderueshëm serash, ndërsa Lumasi ka një reliev kodrinor, i cili mundëson zhvillimin e pemëtarisë.

Gjatë dekadave të fundit, qyteti ka pësuar rënie të ndjeshme popullore, në sajë të largimit të popullsisë për shkak të mundësive të pakta për punësim që ofron zona, duke sjellë për pasojë moshimin e ndjeshëm të popullsisë. Lëvizjet demografike të banorëve të fshatrave drejt qytetit të Kuçovës, veçanërisht në periferi, kanë qenë më të pakta në numër, por duke sjellë për pasojë ngritjen e qendrave të reja të banimit në të cilat mungon infrastruktura.

Kuçova ka një numër total prej 823 njësish ekonomike (viti 2015). Nga këto 92% i takojnë biznesit të vogël dhe vetëm 8% biznesit të madh, pavarësisht numrit relativisht të vogël të njësive ekonomike, krahasuar me numrin e banorëve shpërndarja e tyre është mjaft e lartë. Sektori me numrin më të madh të bizneseve është ai i shërbimeve me 42.65%. Në shërbime janë përfshirë subjektet e restoranteve, hotelierisë dhe bareve, operatorët e transportit e komunikacionit, si edhe shërbime të tjera. Sektori i tregtisë zë 33.54% të njësive ekonomike,

fokusuar kryesisht në biznese të vogla. Sektori me peshë më të ulët është industria 11.06%, përqendruar kryesisht në njësitë Kuçovë dhe Perondi.

Në Bashkinë Kuçovë operojnë 5.318 ferma të klasifikuara si ferma blegtorale, bujqësore ose ferma mikse. Në bashkinë e re funksionojnë 37 subjekte agro-përpunuese, (mbizotërojnë furrat e bukës dhe baxhot, ka fabrika vaji, fabrika konservimi perimesh, sallameri, fabrika prodhimi mielli, etj.). Kontributi i kulturave blegtorale në prodhimtari për qarkun luhartet nga 12%-20%. Toka bujqësore zë rreth 8,184 ha dhe ndodhet në Perondi, Kozarë, Lumas. Toka kultivohet me drithëra, perime (perime në sera), bostanorë, foragjere, ullinj, pemë frutore dhe vreshta. Foragjeret zënë sipërfaqen më të madhe të kultivuar në Kuçovë, me 2,587 ha të ndjekur nga drithërat me 1,592 ha dhe perimet me 360 ha. Kuçova dallohet edhe për rritjen e bagëtisë. Fondi pyjor e kullosor i Bashkisë së Kuçovës është rreth 4,660 ha dhe gjendet kryesisht në tre komunat e bashkisë.

Industria është një sektor mjaft i rëndësishëm për Bashkinë e Kuçovës, e cila nga pikëpamja e punësimit vlerësohet me rreth 17% të numrit të punësuarve në rang bashkie. Zona e Kuçovës është një ndër zonat naftëmbajtëse më të hershme të Shqipërisë, ku është zhvilluar industria e nxjerrjes së naftës si edhe industria përpunuese e saj. Ndërkaq, numri i puseve është më i larti nga gjithë zonat naftëmbajtëse të Shqipërisë: 1090 puse.

Bashkia Kuçovë ka tashmë një Plan të Përgjithshëm Vendor të Territorit që është në proces miratimi.

# 4. METODOLOGJIA

Procesi i Vlerësimit të Komunitetit për Qeverisjen<sup>1</sup> është mjet monitorimi që përdor komunitetin si njësi analize për të nxitur llogaridhënien dhe përgjegjshmërinë sociale dhe publike të institucioneve vendimmarrëse vendore. Vlerësimi i Komunitetit për Qeverisjen njihet ndryshe edhe si “zëri i komunitetit”, pasi i mundëson qytetarëve të shprehin vlerësimin e tyre mbi cilësinë, përshtatshmërinë dhe efikasitetin e shërbimeve publike dhe të propozojë ndryshime në lidhje me shërbimet e ofruara, madje edhe mbi vendimmarrjet vendore. Mekanizmi i VKQ-së zbatohet në një nivel teje të rëndësishëm të qeverisjes, në atë vendor, ku qytetarët janë në kontakt më të drejtpërdrejtë me autoritetet vendimmarrëse dhe mbi të gjitha, me shërbimet e ofruara prej tyre.

Procesi mundëson krijimin e dialogut mes komunitetit dhe autoriteteve vendore, duke përballur mundësitë (burimet që kanë në dispozicion autoritetet vendore) me nevojat reale të komunitetit. Zbatimi i këtij mekanizmi në nivelin vendor ndikon në: zhvillimin e demokracisë me pjesëmarrje dhe arritjen e mirëqeverisjes vendore. Duhet të theksojmë gjithashtu se VKQ-ja nuk është thjesht një proces vlerësimi, pasi shkon përtej tij. Ajo ndërton ndërveprimin mes komunitetit, autoriteteve vendore, organizatave të shoqërisë civile etj, duke krijuar kushte për përmirësime të qëndrueshme të shërbimeve që i ofrohen komunitetit, duke e fuqizuar atë.

**Gjatë procesit të VKQ-së parimet kryesore të vlerësimit të shërbimit (pavarësisht nga çështja objekt i VKQ-së) do janë:**

- **Përshtatshmëria:** programi apo shërbimi a i reflekton nevojat e grupit të targetuar? A i respekton standardet dhe kriteret që përcakton ligji?
- **Efiçenca:** A po përdoren burimet (financiare, njerëzore, lokale) në mënyrë efektive dhe në kohën e duhur? A përfshihet komuniteti në planifikimin e këtyre bulimeve?
- **Pjesëmarrja:** Sa dhe si nxitet pjesëmarrja e komunitetit në planifikimin dhe zbatimin e programit/shërbimeve? Cilat janë metodat që përdorin autoritetet për të nxitur pjesëmarrjen?
- **Qëndrueshmëria:** jetëgjatësia e programeve, shërbimeve. A janë fondet vjetore në rritje apo ato nuk ekzistojnë?
- **Rezultati:** Çfarë ndryshimesh ka sjellë zbatimi i programit/shërbimit? Çfarë rrugësh përdorin autoritetet për të matur ndikimin?

Përfituesit e Vlerësimit të Komunitetit për Qeverisjen janë komuniteti dhe autoritet vendore. **Procesi i VKQ-së i mundëson komunitetit** të informohet mbi shërbimet që ofrohen nga autoritetet vendore; të shprehë opinionin e tij mbi cilësinë dhe efikasitetin e tyre; të monitorojë përmbushjen e detyrimeve/angazhimeve e tyre në ofrimin e shërbimeve cilësore; të shprehë drejtpërdrejtë tek autoritetet përkatëse opinionin e tij dhe t'u kërkojë atyre përmirësimet e

---

<sup>1</sup> Marrë nga Manuali për Shoqërinë Civile “Vlerësimi i Komunitetit për Qeverisjen”- Mbështetur nga Njësia e Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave (UN Women), Shtëpia Botuese IDEART, 2012 Tiranë

nevojshme, si dhe të ndërveprojë me autoritetet përkatëse me qëllim përfitim të shërbimeve cilësore e të qëndrueshme. **VKQ i jep mundësinë autoriteteve vendore** të njohin më mirë nevojat dhe prioritetet e komunitetit në përgjithësi, si dhe të grupeve të veçanta të tij; të orientojnë më mirë burimet që kanë në dispozicion në përputhje me këto nevoja dhe prioritetet e komunitetit, të rrisin kapacitetet e tyre, transparencën në qeverisje dhe të përmirësojnë cilësinë dhe përshtatshmërinë e shërbimeve që i ofrojnë komunitetit.

Proçesi i Vlerësimit të Komunitetit për Qeverisjen realizohet përmes disa etapave, të tilla si: (1) Vlerësimi për ndjekjen e të dhënave (gjetja dhe konsultimi i dokumenteve, materialeve dhe strategjive që lidhen me Bashkinë); (II) Vlerësimi komunitar për performancën (fokus grupe me qytetare të Bashkisë në zonën urbane dhe rurale); (III) Vlerësimi ose vetë-vlerësimi nga ofruesit e shërbimeve (intervista gjysme të strukturuar me autoritetet lokale); (IV) Takimi i drejtpërdrejt midis përfituesve dhe ofruesve (prezantim publik i gjetjeve dhe rekomandimeve nga ky proces dhe (V) Përgatitja e raportit me qëllim institucionalizimin e procesin, advokimin dhe monitorimin.

# 5. PËRSHKRIM I PROJEKTIT

Vlerësimi i Komunitetit për Qeverisjen kaloi në disa faza, të cilat janë të detajuara si më poshtë:

**Skedat e vlerësimit:** Faza përgatitore e projektit ishte shumë e rëndësishme për përcaktimin e aspekteve/fushave që do të mbulonte dhe treguesve që do të përmbante VKQ. Katër fushat e përzgjedhura ishin: (I) cilësia dhe efienca e shërbimeve publike, (II) qeverisja e mirë dhe demokracia lokale, (III) zhvillimi ekonomik dhe (IV) të drejtat e njeriut në nivel vendor. Bazuar në to u përcaktuan edhe 20 treguesit e performancës. U përgatitën tre lloje skedash specifike për qytetin, njësinë administrative dhe një përmbledhëse me vlerësimin e qytetareve dhe ofruesve të shërbimeve. Treguesit që u përdorën për Vlerësimin e Komunitetit për Qeverisjen janë:

## SHËRBIMET PUBLIKE

Rrugët  
Ndriçimi  
Pastrimi  
Gjelbërimi  
Uji i pishëm & kanalizimet

## DEMOKRACIA VENDORE/ MIRËQEVERISJA

Informimi dhe komunikimi  
Transparenca  
Pjesëmarrja në vendimmarrje

## ZHVILLIMI EKONOMIK VENDOR

Planifikimi strategjik  
Planifikimi i buxhetit  
Nxitja e bizneseve  
Nxitja e punësimit  
me fokus te veçantë gratë e të rinjtë






## TË DREJTAT E NJERIUT NË NIVEL LOKAL

Gratë  
Grupet me nevoja të veçanta  
Romët/egjiptianët  
Mbrojtja nga Diskriminimi

**Fokus grupet:** Me synimin e marrjes së mendimit qytetar në muajin korrik u organizuan 5 fokus grupe me përfaqësues të komunitetit dhe banorë të qytetit Kuçovë dhe njësive administrative Kozarë dhe Perondi. Në takime morën pjesë 68 pjesëmarrës (përfaqësues të Komisionit Këshillimor Qytetar Kuçovë, OJQ, individë komunitarë që përfaqësonin grupe të marginalizuara, qytetarë aktivë, kryepaq fshatrash) të cilët me anë të pikëzimit vlerësuan performancën e bashkisë dhe identifikuan nevojat dhe prioritetet e qytetarëve. Në vlerësimin e komunitetit për qeverisjen procesi pati pjesëmarrje të balancuar gjinore 31 meshkuj dhe 37 femra. Gjatë realizimit të fokus grupeve me komunitetin, pjesëmarrësit u prezantuan me qëllimin dhe objektivat e projektit, informacione mbi zbatimin e Reformës Administrative-Territoriale,

ndryshimi i kuadrit ligjor dhe mekanizmat që mbështesin pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje.

**Intervista gjysmë të strukturuar:** Pas takimit me qytetarët u organizuan intervista gjysmë të strukturuar me përfaqësues të Bashkisë, ku u ofruesit e shërbimeve vetë-vlerësuan përmes sistemit të pikëzimit shërbimet që ata ofrojnë për komunitetin. Intervistat përfshinë zv/kryetarin e bashkisë, drejtorinë e shërbimeve, drejtorinë e projekteve dhe administratorët e njësive Kozarë dhe Perondi. Shkalla e vlerësimit sipas pikëzimit që u përdor në Vlerësimin e Komunitetit për Qeverisjen si me qytetarët, ashtu edhe me bashkinë është si më poshtë:

Kriteret		Pikëzimi
Nuk ofrohet shërbim ose cilësia është shumë e dobët		1-Shumë keq
Shërbimi ofrohet, por cilësia është e dobët		2- Keq
Shërbimi ofrohet dhe është relativisht i mirë		3- Çka (mesatar)
Shërbimi ofrohet me cilësi të mirë		4- Mirë
Shërbimi ofrohet me cilësi të lartë		5- Shumë mirë

**Analizimi i të dhënave:** Moment shumë i rëndësishëm i VKQ është hedhja dhe analizimi i të dhënave nga fokus grupet dhe intervistat me ofruesit e shërbimeve. Gjatë kësaj faze është bërë edhe konsolidimi në një skedë i pikëzimit dhe gjetjeve nga qytetarët dhe ofruesit e shërbimeve. Pjesë thelbësore e punës ishte edhe konsultimi me dokumente/strategji dhe informacione të tjera që jepnin një ide më të qartë të fushave dhe treguesve të analizuar.

**Prezantimi publik:** Faza e fundit e VKQ në Bashkinë Kuçovë ishte prezantimi publik i procesit të vlerësimit. Ai u organizua në formën e një forumi publik me qytetarët e Kuçovës. Përveç Kryetarit të Bashkisë dhe stafit të tij, në takim morën pjesë edhe përfaqësues të Komisionit Këshillimor Qytetar Kuçovë, OJQ, individë komunitarë që përfaqësonin grupe të marginalizuara, qytetarë aktivë, administratorë e kryepaq fshatrash të cilët morën pjesë në fokus grupet e organizuara. Takimi përfshiu një prezantim të gjetjeve nga ky proces, dhe në fund u ofruan rekomandimet që dolën nga takimet me qytetarët. Kryetari i Bashkisë vlerësoi procesin si një mundësi e mirë për të marr mendimin e qytetarëve dhe si një formë e mirë për të rritur bashkëpunimin dhe dialogun me ta në të ardhmen. Rekomandimet do të merren parasysh në hartimin e buxhetit të vitit pasardhës, si dhe do të bëhen pjesë e Planit Strategjik të Territorit që është në proces hartimi.

# 6. PËRMBLEDHJE E REZULTATEVE

Siç u shpjegua më sipër në raport, në procesin e Vlerësimit të Komunitetit për Qeverisjen u përfshinë qytetarët e njësisë administrative qendër Kuçovë dhe njësisë administrative Kozarë dhe Perondi. Paralelisht me ta u intervistuan edhe punonjësit e bashkisë/ofruesit e shërbimeve. Çështjet për të cilat u bë monitorimi dhe vlerësimi ishin të ngjashme me ato që u diskutuan nëpër fokus grupet me komunitetin, në mënyrë që të merrej informacion për çështje të njëjta si nga komuniteti, në rolin e përfituesit të shërbimeve, ashtu edhe nga pushteti vendor në rolin e ofruesit të shërbimeve publike. Më poshtë keni rezultatet e dala dhe analizuara nga ky vlerësim.

- a) **Cilësia dhe efiçenca e shërbimeve publike** - rrugë/ trotuare, ndriçim, pastrim, gjelberim, furnizim me ujë të pijshëm dhe kanalizime, kanalet kulluese e vaditese, pyjet e kullotat

CILËSIA DHE EFIÇENCA E SHËRBIMEVE PUBLIKE		
	TË INTERVISTUARIT	PIKËZIMI
QYTET	Qytetarët	3.9
	Ofruesit e shërbimeve	4.5
NJËSI ADMINISTRATIVE	Qytetarët	3
	Ofruesit e shërbimeve	3.5

- b) **Demokracia vendore – mirëqeverisja** – informimi dhe komunikimi, transparenca në vendimmarrje, pjesëmarrja në vendimmarrje

DEMOKRACIA VENDORE – MIRËQEVERISJA		
	TË INTERVISTUARIT	PIKËZIMI
QYTET	Qytetarët	4.4
	Ofruesit e shërbimeve	4.5
NJËSI ADMINISTRATIVE	Qytetarët	3.3
	Ofruesit e shërbimeve	3.5

- c) **Zhvillimi ekonomik vendor** - planifikimi strategjik, nxitja e biznesit, nxitja e punësimit, mbledhja e të ardhurave dhe planifikimi i buxhetit

<b>ZHVILLIMI EKONOMIK VENDOR</b>		
	<b>TË INTERVISTUARIT</b>	<b>PIKËZIMI</b>
<b>QYTET</b>	Qytetarët	<b>3.2</b>
	Ofruesit e shërbimeve	<b>4</b>
<b>NJËSI ADMINISTRATIVE</b>	Qytetarët	<b>3.5</b>
	Ofruesit e shërbimeve	<b>4</b>

- d) **Të drejtat e njeriut në nivel lokal** - gratë, grupe me nevoja të veçanta, romët dhe egjiptianët, mbrojtja nga diskriminimi

<b>TË DREJTAT E NJERIUT NË NIVEL LOKAL</b>		
	<b>TË INTERVISTUARIT</b>	<b>PIKËZIMI</b>
<b>QYTET</b>	Qytetarët	<b>3.2</b>
	Ofruesit e shërbimeve	<b>3.5</b>
<b>NJËSI ADMINISTRATIVE</b>	Qytetarët	<b>2.2</b>
	Ofruesit e shërbimeve	<b>3</b>

Përveç sistemit të pikëzimit pjesëmarrësit në vlerësim patën mundësinë të jepnin edhe komente e sugjerime/rekomandime. Më poshtë po rendisim disa prej gjetjeve dhe rekomandimeve kryesore, që qytetarët dhe ofruesit e shërbimeve kanë bërë në Bashkinë Kuçovë.



# 7. GJETJET KRYESORE

## 7.1 VËSHTRIM KRAHASUES I VLERËSIMIT TË ZONËS URBANE KUNDREJT ZONËS RURALE

Ky vështrim krahasues ndihmon për të kuptuar më qartë diferencat në shërbimet që ofrohen për banorët në territore të ndryshme të bashkisë. Procesi i vlerësimit ka treguar se diferencat aktuale mes zonës urbane dhe rurale brenda territorit të bashkisë vijnë në një masë të konsiderueshme nga mungesa e investimeve në ish-komunat në periudhën përpara reformës territoriale, por gjithsesi janë diferenca që duhet të adresohen në respekt të të drejtës së qytetarëve për të marrë të njëjtat shërbime, pavarësisht zonës ku banojnë. Nga krahasimi i vlerësimeve të kryera nga komuniteti në zonën urbane kundrejt zonës rurale rezulton:

### 7.1.1 Shërbimet Publike – Cilësia dhe Efiçenca

#### Infrastruktura Rrugore

Edhe pse ka ende nevojë për përmirësime në infrastrukturën e rrugëve, e përbashkëta në vlerësimet mes zonave urbane dhe rurale qëndron në faktin që komuniteti i përfshirë në fokus grupe ka ndjerë ndryshime që kanë ndodhur si në zonat urbane dhe në ato rurale. Mbeten problematike rrugët dytësore në zonën urbane dhe rrugët lidhëse në zonën rurale.

#### Shërbimi i Ndrichimi

Ndrichimi në qytet është më cilësor se në periferi dhe duket se kjo çështje mbetet sfidë për bashkinë për shkak të buxhetit të limituar dhe mungesës së investimeve nga ish-komunat tashmë pjesë e bashkisë.

#### Shërbimi i Pastrimit

Në drejtim të cilësisë së pastrimit niveli i kënaqësisë së banorëve në zonat urbane është i ndryshëm nga ai i zonave rurale. Banorët e zonës urbane janë të kënaqur me punën e bashkisë, por ata mendojnë se është koha të fillohet të aplikohet projekti për riciklimin e mbetjeve. Ndërkohë banorët në zonat rurale theksojnë se cilësia e shërbimit të pastrimit është e ulët. Janë siguruar kosha plehrash, por mbetet problem papërgjegjshmëria e banorëve, të cilët i hedhin mbeturinat bujqësore jashtë koshave.

#### Shërbimi i Gjelbërimit

Ndërkohë që qytetarët e lagjeve të brendshme ankohen se nuk kanë mjaftueshëm ambiente të gjelbërta atje ku jetojnë, dhe theksojnë mungesën e hapësirave të gjelbra e shplohëse për fëmijë, gra dhe moshën e tretë, banorët në zonën rurale shprehen se pyjet dhe kullotat mirëmbahen.

#### Furnizimi me ujë dhe kanalizimet

Paraqiten njësoj problematike nga banorët si në zonën urbane ashtu edhe atë rurale. Në zonën urbane uji vazhdon të jetë me orare të kufizuara dhe kjo bëhet me problematike në stinën e verës. Problematike mbeten kanalizimet, për shkak të ndërtimeve të bëra mbi kolektorë. Në

zonën rurale furnizimi me ujë është jo i kënaqshëm. Në verë ka ujë një herë në ditë, por ka zona ku ka dy herë në javë. Kanalizimet janë të amortizuara dhe shpesh përzihen me ujërat e zeza.

### **Transporti Publik**

Banorët e zonave rurale ankohen për transportin publik që është inekzistent.

## **7.1.2 Demokracia Vendore dhe Mirëqeverisja**

### **Informimi dhe komunikimi**

Si në zonën urbane ashtu edhe në atë rurale vlerësimi i komunitetit për cilësinë e informimit nga autoritetet vendore si dhe komunikimin me ta është shumë i mirë. Banorët në zonën urbane referuan se Bashkia për të informuar qytetarët përdor: faqe zyrtare web, gazeta lokale, faqja e facebook dhe afishimet në këndin e njoftimeve, ndërsa në zonën rurale informacioni shpallet në këndin e lajmërimeve, me letra, telefon, korrierë ose në lokalitete të fshatit me zinxhir lajmërimi.

### **Transparenca në vendimmarrje**

Bashkia organizon takime publike me qytetarët si në zonën urbane dhe në rurale dhe ka mekanizëm për të garantuar informimin, transparencën dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në këto takime, por ato jo gjithnjë arrijnë drejtpërdrejt tek qytetarët.

### **Pjesëmarrja në vendimmarrje**

Qytetarët e dinë që mbledhjet e këshillit bashkiak janë të hapura dhe pohojnë se marrin pjesë në mbledhje veç kur kanë probleme dhe rrallë nëse dëshirojnë të ndjekin punimet e mbledhjes dhe mendojnë se vendimmarrja nuk u përket atyre, kjo më e shprehur në zonën rurale. Qytetarët si në zonën urbane dhe në atë rurale mendojnë se këshilli bashkiak duhet të jetë më aktiv në ndërmarrje nismash në të mirë të komunitetit, apo në takime më të shpeshta me ta.

## **7.1.3 Zhvillimi Ekonomik Vendor**

### **Planifikimi Strategjik**

I gjithë zhvillimi ekonomik në territorin e Bashkisë së Kucovës mbështetet mbi Planin Strategjik 2015-2017. Është e rëndësishme që ky plan ka në fokus si zonën urbane, ashtu edhe atë rurale. Megjithatë qytetarët duken të painformuar për egzistencën e këtij plani. Ndërkohë që bashkë me Planin e Përgjithshëm Vendor të Territorit është hartuar edhe Strategjia Territoriale e Bashkisë Kuçovë, e cila do të orientojë punën dhe politikën e bashkisë për një periudhë pesëmbëdhjetë vjeçare.

### **Nxitja e biznesit**

Në zonën urbane bashkia ka krijuar lehtësi fiskale duke ulur taksat me 30%. Gjithashtu, është hequr taksat e regjistrimit fillestar të biznesit dhe janë lehtësuar procedurat përmes shërbimit one-stop-shop. Për zonën rurale janë përcaktuar investimet në kanale kulluese e vaditëse, nxitje dhe lehtësim të fermerëve që sjellin të ardhura nga 5 dynmëshi tokë që u jepet pa qira për 5 vite, por banorët e zonave rurale mendojnë se administratorët duhet të kërkojnë subvencionim të naftës për transport prodhimesh bujqësore, traktorë e autokombajna, si edhe një qendër grumbullimi për prodhimet bujqësore e blegtorale.

### **Nxitja e punësimit**

Edhe pse nuk ka njësi të posaçme që të merret me çështjet e punësimit, Bashkia ka ndërmjetësuar tek biznesi fason për punësim të grave, ndërsa në zonën rurale edhe pse

pranohet që ka një koordinim më të mirë të biznesit të fermerëve me bashkinë për grumbullimin dhe shitjen e prodhimeve bujqësore, fermerët në njësitë administrative ankohen për mungesa në këtë drejtim. Bashkia nuk ka një studim lidhur me situatën e papunësisë.

### **Mbledhja e taksave**

Niveli i mbledhjes së taksave në bashkinë e Kucovës i shprehur në përqindje është afërsisht 86%, konkretisht në zonat urbane 90% dhe në zonat rurale 75%. Nuk është bërë asnjë fushatë sensibilizuese për mbledhjen e tyre. Qytetarët mendojnë se duhet të rritet punësimi dhe niveli ekonomik që të rritet niveli i mbledhjes së taksave dhe të ardhurave të Bashkisë. Bashkia ka parashikuar koordinim më të mirë të strukturave vendore e shtetërore për disa taksa, të cilat duhet të futen në sistem.

## **7.1.4 Të drejtat e njeriut në nivel lokal**

### **Gratë**

Bashkia nuk ka programe për adresimin e dhunës me bazë gjinore, por ka një punonjës të barazisë gjinore. Qytetarët si në zonën urbane dhe atë rurale përforcojnë idenë e bashkisë se shkollat bëjnë punë të mirë për sensibilizim, ndërgjyegjesim dhe informim për dhunën ndaj grave përmes aktiviteteve të ndryshme. Gjithashtu banorët si në zonat rurale dhe në urbane kanë dijeni për bashkëpunim të organizatave të grave me pushtetin lokal për projekte me fokus gruan, edhe pse bashkia nuk ka ende programe të veçanta për këtë problem. Sfidë mbetet mungesa e buxhetit dhe e një qendre rehabilitimi për viktimat e dhunës. Pushteti lokal nuk ka ende statistika për raste dhune.

### **Grupe me nevoja të veçanta**

Përpjekjet e bashkisë për të siguruar fonde përmes projekteve për fëmijët me aftësi të kufizuar flasin për përgjegjshmëri kundrejt këtij grupi. Ndërkohë për fëmijët me nevoja të veçanta bashkia ka vënë në dispozicion një mjet transporti për çuarjen e tyre në shkollë. Ngritja gjithashtu e shërbimit për moshën e tretë është gjithashtu me shumë vlerë, megjithatë mungojnë shërbime specifike për të moshuarit në zonën rurale, shërbime rehabilituese për fëmijë me aftësi të kufizuara, si dhe gratë viktime të dhunës në familje.

### **Mbrojtja nga Diskriminimi**

Komuniteti në zonën urbane rezulton i informuar mbi ekzistencën e ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi, jo vetëm se bashkia ka programe dedikuar mbrojtjes nga diskriminimi, por edhe për faktin se shkollat bëjnë punë të mirë në këtë drejtim. Ndryshe ndodh me komunitetin në zonën rurale i cili nuk ka dijeni për ekzistencën e ligjit. Qytetarët nuk e dinë që ekziston Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ndërkohë që Bashkia ka marrëveshje bashkëpunimi me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi

# 8. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

## 8.1 KONKLUZIONE PËR QYTETIN

### 8.1.1 Shërbimet Publike – Cilësia dhe Efiçenca

#### Infrastruktura rrugore

Perceptimi qytetar për cilësinë e rrugëve është se po bëhet punë e mirë nga bashkia për të shtuar sasinë e rrugëve të standardeve të larta. Specialistët e shërbimit të rrugëve në bashki mendojnë se, ndërkohë që rrugët kryesore janë të mirëmbajtura, mungesa e fondeve ka sjellë vështirësi për rrugët dytësore. Bashkia ka një plan afatgjatë për ndërhyrje, e cila do të sjellë stabilitet të këtij shërbimi dhe po bëhet paralelisht me rrjetin e ri të ujësjellësit, i cili përfundon në vitin 2017. Kjo do të stabilizojë edhe gjendjen e rrugëve, të cilat do të jenë të standardeve të larta. Bashkia ka përcaktuar edhe prioritetet e ndërtimit dhe mirëmbajtjen e rrugëve, të cilat do të bëhen në përputhje me numrin e banorëve dhe afërsinë me bizneset kryesore. Është marrë mendimi i Komisionit Qytetar në dëgjesa e zhvilluara për këtë çështje. Në dëgjesa për hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Territorit janë përcaktuar mes të tjerash edhe trotualet për nevojat e të gjithë përdoruesve (PAK) dhe të moshuarit. Qytetarët gjithashtu mendojnë se hartuesit e projekteve duhet të ndërmarrin projekte serioze, me ndikim afatgjatë dhe të sigurta për të patur rrugë të standardeve bashkëkohore. Sinjalistika rrugore gjendet në kushte të mira, pasi firma sipërmarrëse në bashkëpunim me drejtorinë e shërbimeve kanë punuar për të patur një produkt cilësor. Ka bashkëpunim të mirë edhe me policinë rrugore.

#### Shërbimi i ndriçimit

Vlerësohet përgjithësisht pozitiv si nga pushteti lokal ashtu edhe nga qytetarët, por ka ende shumë punë për t'u bërë. Ndriçimi në qytet është më cilësor se në periferi. Po punohet për shtrirjen e shërbimit të ndriçimit edhe në zonat rurale. Specialisti i shërbimit në bashki thekson se cilësia e dobët e këtij shërbimi në zonat periferike të bashkisë është sfidë, për shkak të mungesës së investimeve nga ish-komunat. Janë planifikuar dhe projektuar skema të reja për të përmirësuar ndriçimin, veçanërisht në zonat periferike të bashkisë, dhe kjo reflektohet edhe në rritjen krahasimore të buxhetit për këtë shërbim. Sfidë e këtij shërbimi mbetet mungesa e fondeve për shkak të mosrealizimit të të ardhurave.

#### Shërbimi i Pastrimit

Shërbimi i pastrimit mbulohet nga kompania e kontraktuar, e cila punon për përmbushjen e detyrave kundrejt detyrimeve kontraktore. Mbeturinat zhvendosen çdo mëngjes në gjashtë ditë të javës dhe banorët janë të kënaqur me punën e bashkisë, por ata mendojnë se është koha të fillohet të aplikohet projekti për riciklimin e mbetjeve. Ka edhe lagje të pasistemuara ku ka gropa

të mbetura nga ish-puset e naftës të mbushura me plehra që s'pastrohen dhe ku mungojnë higjiena dhe hapësira çlodhëse. Bashkia ka në plan disiplinimin e mbetjeve urbane.

### **Shërbimi i Gjellbërimit**

Bashkia Kuçovë ka një sipërfaqe të konsiderueshme të zonës së gjellbër. Është mbrojtur me fanatizëm kjo zonë, por qytetarët e lagjeve të brendshme ankohen se nuk e kanë këtë shërbim atje ku jetojnë, veçanërisht, theksojnë mungesën e hapësirave të gjelbra e çlodhëse për fëmijë, gra dhe moshën e tretë. Ka plane dhe buxhet për zgjerimin dhe shtimin e sipërfaqes së gjellbër dhe punohet çdo ditë për mirëmbajtjen e saj.

### **Furnizimi me ujë dhe kanalizimet**

Qytetarët dhe bashkia ndajnë të njëjtin konstatim se furnizimi me ujë mbetet një nga sfidat më kryesore. Uji vazhdon të jetë me orare të kufizuara dhe kjo bëhet më problematike në stinën e verës. Mbledhja e tarifës së ujit realizohet në masën 85%. Qytetarët e perceptojnë cilësinë e ujit si më të mirë krahasuar me kohë më parë dhe, sipas shpjegimit të specialistit, kjo ndodh falë terrenit të përthyer, me rrjedhje të ujerave në kursin e destinuar të cilat nuk përzihen me ujërat e zeza. Njëkohësisht, cilësia e ujit mbahet nën vëzhgim në pikat e kontrollit dhe bëhen përpjekje për të shmangur ndotjen bakteriale në bashkëpunim me D.SH.P. Projekti i ri për ujësjellësin do të sjellë çarje të tjera të rrugëve dhe kjo kërkon informim të vazhdueshëm të qytetarëve për cilësinë, ndërprerjet apo mungesat e ujit. Problematike mbeten kanalizimet, për shkak të ndërtimeve të bëra mbi kolektorë. Kanalizimet dhe largimi i ujërave të ndotura paraqesin probleme, pasi kanalizimet janë të amortizuara dhe kanali mbledhës është i hapur në dalje të Kuçovës. Rrjeti i ri i ujësjellësit, i cili pritet të përfundojë në 2017, do të përmirësojë ndjeshëm cilësinë dhe furnizimin me ujë.

## **8.1.2 Demokracia dhe Mirëqeverisja**

### **Informimi dhe komunikimi**

Sipas perceptimit qytetar, Bashkia e Kuçovës ka bere pune të lavdërueshme për garantimin të drejtës së qytetarëve për të marrë të dhëna apo informacionin që u duhet. Për të informuar qytetarët përdoren: faqja zyrtare ueb, gazeta lokale, faqja e Facebook dhe afishimet në këndin e njoftimeve. Përgjithësisht përgjigjet kthehen brenda 10 ditëve punë, në raste të veçanta ato zgjasin për arsye të informacionit që përmbajnë. Përgjigjet priren të jepen të sakta, edhe pse shpesh saktësia e informacionit nuk varet nga zyra e informacionit, por nga drejtoritë përkatëse. Është ndërtuar një sistem efikas ankimimi të qytetarëve online tek portali [përmirësoqytetin.al](http://përmirësoqytetin.al), në faqen e web ose qytetarët mund të vijnë pranë zyrës së informacionit për të plotësuar formularin e kërkesë/ankesave. Kjo zyrë shpall njoftime me interes për qytetarët në median e shkruar apo vizive. Vazhdimisht merren parasysh kërkesat e qytetarëve, si në lidhje me infrastrukturën ashtu edhe me nevojat social-ekonomike të tyre. Bashkia ka caktuar koordinatorin për të drejtën e informimit, por ende nuk është hartuar programi i transparencës, dhe nuk ka regjistër kërkesa/ankesash. Bashkia ka faqen online [www.bashkiakucove.gov.al](http://www.bashkiakucove.gov.al). Komisioni Qytetar është mjaft aktiv në sjelljen e ideve dhe i paraqet ato si prioritete të zhvillimit në dëgjesa publike dhe takime të ndryshme me pushtetin lokal.

### **Pjesëmarrja në vendimmarrje**

Bashkia organizon takime publike me qytetarët dhe ka mekanizëm për të garantuar informimin e qytetarëve dhe pjesëmarrjen e tij të gjerë në këto takime, por ato jo shpesh arrijnë tek qytetarët.

Përfshirja e mendimit/opinionit të shprehur nga qytetarët në takimet e zhvilluara në vendimmarrjet e bashkisë/këshillit bashkiak është sfidë së cilës i duhet gjetur zgjidhja. Qytetarët e dinë që mbledhjet e këshillit bashkiak janë të hapura dhe pohojnë se marrin pjesë në mbledhje veç kur kanë probleme dhe rrallë nëse dëshirojnë të ndjekin punimet e mbledhjes; mendojnë se vendimmarrja nuk u përket atyre. Qytetarët mendojnë se këshilli bashkiak duhet të jetë më aktiv në ndërmarrje nismash në të mirë të komunitetit, apo në takime më të shpeshta me ta. Në Bashkinë e Kuçovës qytetarët e dinë që prej vitesh ka një Komision Qytetar. Bashkia bën takime të shpeshta me Komisionin Qytetar, veçanërisht për vendime që ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e qytetarëve, edhe për faktin se ai është shumë përfaqësues, falë përbërjes së tij të ndryshme. Bashkëpunimi mes Komisionit Qytetar dhe bashkisë është shumë frutdhënës. Çdo vit para se të miratohet buxheti, Bashkia organizon dëgjesa për të marrë prioritete zhvillimi të mbledhura nga komisioni në kontakt me qytetarët. Për çdo dëgjese qytetarëve u vihet në dispozicion adresa e emailit të bashkisë dhe një periudhë kohe për të shprehur opinionet, sugjerimet apo ankesat e tyre. Qytetarët e vlerësojnë maksimalisht transparencën e bashkisë dhe mendojnë se bashkia është një zyrë e hapur ku mund të gjejsh informacionin dhe shërbimin e kërkuar në kohë dhe me cilësi.

### **8.1.3 Zhvillimi Ekonomik Vendor**

#### **Planifikimi strategjik**

I gjithë zhvillimi ekonomik në territorin e Bashkisë së Kuçovës mbështetet mbi Planin Strategjik 2015-2017. Edhe pse qytetarët nuk dinë të thonë nëse ka plan strategjik zhvillimi, bashkia e ka publikuar atë në faqen online të saj. Zyra e Zhvillim Koordinimit njihet nga qytetarët edhe pse nuk dinë ndonjë informacion për projekte konkrete të kësaj zyre. Në bashkëpunim me AZHR, Bashkia ka aplikuar projekte që do të nxisin zhvillimin e turizmit, si p.sh. zonën e Sinecit, kishat e Kozares dhe Perondisë, duke krijuar mundësi më të mira për punësim dhe ulje varfërie. Janë përgatitur guida ditore, është synuar drejt një turizmi historik për naftë-nxjerrjen dhe historikun e saj, agroturizmin dhe promovimin e marketimin e produkteve, guest houses, etj. Të gjitha këto kanë në fokus nxitjen e ekonomisë lokale, punësimin, veçanërisht të të rinjve e grave. Prioritet po u jepet edhe nxitjes së fermerëve përmes përmirësimit të sistemit vaditës dhe kullues, si edhe lidhjes së bashkisë dhe njësinë administrative Lumas me rrugë të asfaltuar për një shërbim të shpejtë e më të mirë të lëvizjes së produkteve bujqësore drejt konsumatorit.

#### **Nxitja e biznesit**

Strategjia kryesore e pushtetit vendor për nxitjen e biznesit është konkurrenca e barabartë. Ekzistojnë rreth 100 biznese aktive dhe që paguajnë tarifën vendore. Si lehtësi fiskale janë ulur taksat me 30% dhe është hequr taksa e regjistrimit fillestar të biznesit. Bashkia bën takime të vazhdueshme me përfaqësues të biznesit dhe i mbështet ato. Gjithashtu, pushteti lokal mendon se tendenca e zhvillimit të biznesit privat do krijojë punësim si rezultat i lehtësirave të krijuara për të, por nuk ka ndonjë shifër, statistikë apo studim se sa vende të reja pune janë krijuar dhe as se sa gra apo individë të grupeve vulnerabël janë punësuar. Është arritur një koordinim më i mirë i biznesit të fermerëve me bashkinë për grumbullim dhe shitjen e prodhimeve bujqësore, edhe pse fermerët në njësitë administrative ankohen për mungesa në këtë drejtim.

#### **Nxitja e punësimit**

Bashkia nuk ka njësi të posaçme që të merret me çështjet e punësimit, por në planin e vet strategjik, parashikon zhvillime dhe projekte që do të zbusin papunësinë. Ka ndërmjetësuar tek

biznesi fason për punësim grash, por qytetarët shtojnë se Inspektorati i Lartë i Punës duhet të ushtrojë kontrolle për pagat e ulta të punonjësve përkundrejt një shfrytëzimi maksimal. Bashkia nuk ka një studim lidhur me situatën e papunësisë dhe qytetarët e perceptojnë papunësinë në shifrat 70-80%, që prek më shumë rininë dhe gratë, veçanërisht ato mbi 45 vjeç. Bashkia përpiqet të bëjë rolin e ndërmjetësit mes bizneseve private dhe të interesuarave për pune dhe gjithashtu e ka prioritet punësimin e grupeve në nevojë.

### **Mbledhja e të ardhurave dhe planifikimi i buxhetit**

Niveli i mbledhjes së taksave në bashkinë e Kuçovës i shprehur në përqindje është afërsisht 86% (në zonat urbane 90% dhe në zonat rurale 75%). Nuk është bërë asnjë fushatë sensibilizuese për mbledhjen e tyre. Qytetarët theksojnë se nuk thirren në mbledhjet për buxhetin, ndërsa, nga ana e saj, Bashkia aktivizon Komisionin Qytetar për përcaktimin dhe sjelljen e prioriteteve të zhvillimit të cilat përkthehen në shifra buxheti. Janë bërë takime në lagje dhe në njësitë administrative, si edhe sjellja e prioriteteve nga administratorët dhe kryetarët e fshatrave, të cilët janë pjesë e grupit të hartimit të buxhetit. Debatet për buxhetin janë të hapura. Banorët në të dyja zonat informohen me fletëpalosje, broshura, në faqen online të bashkisë, në profilin e saj në Facebook, si edhe me njoftime nëpërmjet këshilltarëve. Bashkia ka parashikuar koordinim me të mirë të strukturave vendore e shtetërore për disa taksa, të cilat duhet të futen në sistem. Propozojnë që taksa e ndërtesës të futet në faturën elektrike si tarifën e tjera, pasi shumica vjetore prej 5-6 mijë lekësh nuk është ndonjë rëndesë mbi financat familjare.

#### **8.1.4 Të Drejtat e Njeriut në Nivel Lokal**

##### **Gratë**

Bashkia nuk ka programe për adresimin e dhunës me bazë gjinore, por ka një punonjës të barazisë gjinore. Mekanizmi i referimit nuk është ngritur, ekziston një këshilli teknik dhe takime zhvillohen vetëm me të. Bashkia pohon se janë organizuar fushata informimi në bashkëpunim me organizata lokale grash dhe DAR Kuçovë. Qytetarët kanë dijeni për bashkëpunim të organizatave të grave me pushtetin lokal për projekte me fokus gruan, edhe pse bashkia nuk ka ende programe të veçanta për këtë problem. Organizatave lokale të grave u ofrohen ambiente falas, u paguhen dritat dhe uji, por këto janë bashkëpunime të shkurtra e sporadike. Organizatat e grave i përkrahin shtresat në nevojë duke i punësuar e angazhuar në projektet e tyre. Referohen raste edhe nga njësitë administrative, si edhe linja 24-orëshe për referimin e rasteve të dhunës. Pushteti lokal nuk ka ende statistika për raste dhune. Ka pjesëmarrje të mirë të grave në vendimmarrje lokale nëse mbajmë në konsideratë faktin që 51% e anëtarëve të këshillit bashkiak janë gra.

##### **Romët dhe Egjiptianet**

Bashkia bashkëpunon me organizatat lokale të romeve dhe mbështet projekte të vazhdueshme për ta. Qytetarët perceptojnë se egjiptianët vazhdojnë të integrohen shumë më mirë se romët në komunitet, ndërsa romët janë më rezistentë ndaj integritit dhe bashkëpunimeve. Bashkia paguan ushqimin e 8 fëmijëve romë në kopsht. Pjesëmarrësit janë të ndërgjegjshëm edhe për mundësitë e kufizuara financiare të bashkisë. Ata mendojnë se me këto mundësi puna e bashkisë është e kënaqshme. Qytetarët pohojnë se herë pas here janë organizuar fushata sensibilizuese në komunitet, veçanërisht në bashkëpunim me shkollat dhe DAR Kuçovë. Bashkia thotë se nuk ka struktura të cilat të merren posaçërisht me këtë çështje.

## **Grupe me nevoja të veçanta**

Shërbimi social ka prioritet dhënien e shërbimeve në kohë dhe me cilësi për të gjitha shtresat në nevojë: fëmijët, gratë, personat PAK, familjet. Me mundësitë aktuale, të cilat nuk janë më të mjaftueshme, deri tani ky shërbim është mbuluar me buxhetin e bashkisë. Bashkia ka aplikuar për një projekt evropian i cili përfshin komunitetin PAK dhe që ka në fokus mobilitetin e tyre fizik, si edhe atë elektronik. Ai përfshin vendosjen e rampeve në shkolla, konferenca dhe takime të përbashkëta me PAK jashtë kufijve të vendit. Pjesëmarrësit janë në dijeni të funksionimit të një qendre për moshën e tretë. Në bashkëpunim me Kryqin e Kuq, i cili ofron kafe falas dhe organizon udhëtime e aktivitete të ndryshme, bashkia ka ofruar sallën falas dhe paguan tarifat vendore. Gjithashtu bashkia ka ndërmarrë një projekt shëndetësor falas për këtë kategori sociale. Përveç këtyre, pjesëmarrësit përmendin paketat ushqimore falas për moshën e tretë të qendrës, si edhe paketa ushqimore falas për çdo vit të ri për njerëzit në nevojë. Qytetarët mendojnë se bashkia duhet të jetë më aktive dhe të mendojë më shumë për këtë shtresë duke aplikuar në projekte e bashkëpunime efektive.

## **Mbrojtja nga diskriminimi**

Komuniteti është i informuar mbi ekzistencën e ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi, jo vetëm se bashkia ka programe dedikuar mbrojtjes nga diskriminimi, por edhe për faktin se shkollat bëjnë punë të mirë në këtë drejtim. Pushteti lokal nuk ka ngritur struktura të veçanta të njësisë vendore për këtë problem. Strukturat janë të ndërthurura me mbrojtjen e fëmijëve, dhunës në familje, etj. Qytetarët nuk e dinë që ekziston Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ndërkohë që bashkia ka marrëveshje bashkëpunimi me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

## **8.2 KONKLUZIONE PËR NJËSITË ADMINISTRATIVE**

### **8.2.1 Cilësia dhe Efiçenca e Shërbimeve Publike**

#### **Infrastruktura Rrugore**

Komuniteti mendon se ka përmirësime në rrugët që lidhin qendrën e njësisë me Kuçovën, por ato mbeten problematike. Nuk e dinë në sa rrugë do ndërhyhet, por e dinë që njësia ka përcaktuar prioritete që i ka paraqitur në bashki dhe do jenë pjesë e planit të përgjithshëm të zhvillimit. Idetë mblidhen në konsulta me banorët. Për banorët e Perondisë, trotuaret nuk janë të përshtatura as aty ku ekzistojnë, ndërsa për banorët e Kozarës ka trotuare që mirëmbahen dhe u vijonë në ndihmë të moshuarve dhe fëmijëve.

#### **Pastrimi**

Banoret theksojnë se cilësia e këtij shërbimi është e ulët. Janë siguruar kontenierë, por mbetet problem papërgjegjshmëria e banorëve, të cilët i hedhin mbeturinat bujqësore jashtë kontenierëve. Administratorët e të dy njësive theksojnë se në planin e bashkisë ka ide për përmirësime.

#### **Furnizimi me ujë të pijshëm**



Furnizimi me ujë është jo i kënaqshëm. Në verë ka ujë 1 herë në ditë por ka zona ku ka 2 herë në javë. Kanalizimet janë të amortizuara dhe shpesh përzihen me ujërat e zeza. Janë paraqitur prioritetet nga administratorët e të dy njësive gjatë diskutimit të planit të zhvillimit dhe buxhetit.

### **Pyjet / kullotat**

Sipas banorëve, pyjet dhe kullotat mirëmbahen. Po kështu edhe të dy njësitet administrative janë angazhuar për këtë çështje. Kryetarët e fshatrave të dy njësive bashkëpunojnë me administratorin dhe organet e rendit për referim rastesh dëmtuesish të tyre.

### **Kanalet kulluese/vaditëse:**

Për sistemin e kullimit dhe ujitjes, Bashkia e Kuçovës ka parashikuar të bëjë investime në të ardhmen. Banorët pohojnë se ka përmirësime krahasuar me vitet e kaluara, por shpesh, teket e motit dhe shirat e mëdha ende përmbytin toka dhe vështirësojnë kullimin e tyre. Mungesa e gjatë e investimeve për rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre përbën sfidë.

## **8.2.2 Demokracia dhe Mirëqeverisja**

### **Informimi dhe komunikimi**

Njësitet administrative garantojnë të drejtën e qytetarëve për të marrë të dhëna/informacion apo kopje të akteve/vendimeve të bashkisë. Informacioni shpallet në këndin e lajmërimeve me letra, telefon, korrierë ose në lokalitë të fshatit me zinxhir lajmërimi. Banorët janë të kënaqur me punën e administratorëve të njësive Kozare dhe Perondi. Ata janë të gatshëm t'u japin banorëve informacion të saktë. Në zyrat e njësive administrative zhvillohen ditë pritjeje, por ka edhe banorë që e gjejnë atë në faqen zyrtare të bashkisë. Nuk ka sistem ankimi përveç takimeve në zyrën e njësive administrative, në kafene, në rrugë e kudo që kanë mundësi. Në takime me komunitetin janë përcaktuar prioritetet e zhvillimit si edhe nevojat e banorëve, të cilat paraqiten në takimet me bashkinë.

### **Pjesëmarrja në vendimmarrje**

Banorët e të dy njësive pohojnë se janë bërë takime publike e konsulta për të diskutuar prioritetet e buxhetit apo për çështje që influencojnë direkt jetën e tyre në bashkëpunim me Komisionin Qytetar, i cili ka anëtarët e vetë përfaqësues nga zonat si edhe në zyrat e administatorëve apo biseda miqësore në lokalet e njësive. Çështjet më të qenësishme të diskutimeve kanë të bëjnë me papunësinë, varfërinë, ujin, rrugët, kanalet kulluese, transportimin e prodhimeve bujqësore e blegtorale drejt tregjeve, etj. Në perceptimin e banorëve, kryetarët e fshatrave janë bashkëpunues me njësinë, duke konstatuar, denoncuar dhe përcaktuar zgjidhje shkëlqesh, konfliktesh e problemesh. Banorët e dinë që mbledhjet e këshillit bashkiak janë të hapura, por pranojnë se sfidë për ta mbetet indiferentizmi qytetar dhe roli i vakët, e shpesh i munguar, i anëtarit të këshillit bashkiak të njësive.

## **8.2.3 Zhvillimi Ekonomik Vendor**

### **Planifikimi strategjik**

Administratorët e njësive mendojnë se rëndësi në planin e zhvillimit i jepet rritjes së cilësisë së shërbimeve përmes investimeve. Si element të ndjeshëm gjinor, banorët dhe njësitet shohin investimet në kopshte e çerdhe, si edhe bashkëpunimin me organizata të shoqërisë civile ose

ndërmjetësim të bashkisë në sipërmarrjet fasone për punësim grash dhe vajzash. Prioritete të tjera për njësitë administrative mbeten kanalet kulluese dhe vaditëse, uji i pijshëm dhe rrugët.

### **Nxitja e punësimit/biznesit**

Në prioritetet e njësive janë përcaktuar investimet në kanale kulluese e vaditëse, nxitje dhe lehtësim të fermerëve që sjellin të ardhura nga 5 dynmëshi tokë që u jepet pa qira për 5 vite. Banorët e njësive mendojnë se administratorët duhet të kërkojnë subvencionim të naftës për transport prodhimesh bujqësore, traktorë e autokombajna, si edhe një qendër grumbullimi për prodhimet bujqësore e blegtorale.

### **Mbledhja e të ardhurave**

Informimi i banorëve për detyrimet tarifore bëhet përmes lajmërimeve. Pjesëmarrësit në fokus grup mendojnë se niveli aktual i mbledhjes së të ardhurave lidhet më shumë me mundësitë e kufizuara ekonomike të disa familjeve. Banorët dhe administratorët mendojnë se të ardhurat do t'u transferohen si investime në rrugë, ujë e kanalizime, kanale kulluese e vaditëse, jetë më të mirë.

## **8.2.4 Të Drejtat e Njeriut në Nivel Lokal**

### **Çështje të barazisë gjinore dhe adresimi i dhunës në familje**

Banorët perceptojnë se nuk ka dhunë, ata mendojnë se ka ndërgjegjësim të komunitetit kundër dhunës ndaj gruas dhe thonë se institucionet arsimore bëjnë punë të mirë me aktivitetet për ndërgjegjësim e edukim. Nuk ka statistika për dhunën. Gratë e dhunuara dhe në nevojë ndihmohen në mënyrë sporadike nga veprimtari bamirëse ose nga vetë komuniteti, gjë që është tregues i mungesës së rolit të bashkisë në ofrimin e shërbimeve rehabilituese për to. Si komuniteti, ashtu edhe administratorët nuk njohin programe adresimi dhune.

### **Grupe me nevoja të veçanta**

Komuniteti mendon se bashkia duhet të ketë programe të veçanta për mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të këtij grupi si dhe përfshirjen sociale të tyre. Administratorët theksojnë se për fëmijët me nevoja të veçanta bashkia ka vënë në dispozicion një për transportin e tyre në shkollë. Mungojnë shërbime specifike për të moshuarit dhe rehabilituese për fëmijë me aftësi të kufizuara.

### **Mbrojtja nga diskriminimi**

Banorët nuk kanë dijeni për punën e bashkisë për këtë çështje, por administratorët e njësive administrative e dinë ekzistencën e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. As ata nuk kanë dijeni nëse bashkia ka ndonjë program me fokus mbrojtjen nga diskriminimi

## **8.3 REKOMANDIME**

Rekomandimet në vijim i referohen problematikave të konstatuara nga komuniteti në të gjithë territorin e Bashkisë:

- Vlerësimi tregoi se në shumë çështje ka diferenca mes shërbimit që ofrohet në zonën urbane me atë në zonën rurale brenda territorit të bashkisë, prandaj autoritetet vendore duhet të analizojnë këto diferenca dhe në planet e tyre t'i adresojnë për t'i eliminuar gradualisht e për të respektuar të drejtën e banorëve për të marrë shërbime të njëjta pavarësisht nga vendbanimi i tyre.
- Rekomandohen ndërhyrje në infrastrukturën e rrugëve dytësore dhe rrugët lidhëse, sikurse vijimi i praktikës së mirë të krijuar për t'i bërë trotualet e aksesueshme për të gjithë përdoruesit (edhe për personat me aftësi të kufizuara, karrocet e fëmijëve dhe të moshuarit).
- E nevojshme ndërhyrja e bashkisë në lidhje me transportin publik që duhet të lidhi veçanërisht zonën urbane me atë rurale.
- Shtrirje e ndriçimit edhe në zonat rurale dhe adresimi i problematikës së ndriçimit në zonat periferike.
- Rekomandohet fillimi i projektit për riciklimin e mbetjeve, sikurse në zonën urbane kërkohet ndërhyrje në lagjet ku ka gropa të mbetura nga ish-puset e naftës të mbushura me plehra që s'pastrohen. Në zonën rurale përveç shtimit të kontenierëve për hedhjen e mbeturinave (atje ku është e nevojshme), duhet punuar për ndërgjegjësimin e banorëve për përdorimin e tyre.
- Shtim i hapësirave të gjelbra dhe çlodhëse në lagjet e brendshme të qytetit.
- Rrjeti i ri i ujësjellësit zgjidh problematikën e ngritur nga komuniteti, por rekomandohet që gjatë periudhës së kryerjes së punimeve të ketë informim të vazhdueshëm të qytetarëve për cilësinë, ndërprerjet apo mungesat e ujit. Duhet adresuar problematika me kanalizimet, që vijnë nga ndërtimet e kryera mbi kolektorë.
- Bashkia duhet të vijojë me mekanizmat dhe praktikën shumë të mirë të ngritur për informimin dhe përfshirjen e komunitetit në vendimmarrje. Koordinatorin për të drejtën e informimit duhet të hartojë programin e transparencës, si dhe të përgatisë regjistrin e kërkesë/ankesave.
- Këshilli bashkiak duhet të jetë më aktiv në ndërmarrje nismash në të mirë të komunitetit, apo në takime më të shpeshta me ta, nga një anë për të kuptuar më mirë nevojat, prioritetet e komunitetit dhe mënyrën se si bashkia i adreson këto nevoja që kanalizohen në vendimet e këshillit, si dhe nga ana tjetër edhe për të eliminuar indiferentizmin që banorët shfaqin ndaj aktivitetit të këtij këshilli.
- Bashkia duhet t'i kushtojë vëmendje mbledhjes dhe analizës së të dhënave statistikore të cilat në fakt e ndihmojnë për të vlerësuar më mirë prioritetet dhe politikat që duhet të ndërmarrë. Në mënyrë të veçantë të dhëna duhet të mbledhen e analizohen në lidhje me punësimin/papunësinë, rastet e dhunës në familje, etj.

- Për nxitjen e bujqësisë banorët kanë rekomanduar subvencionim të naftës për transport prodhimesh bujqësore, traktorë e autokombajna, si edhe një qendër grumbullimi për prodhimet bujqësore e blegtorale.
- Bashkia duhet të luaj një rol më aktiv në adresimin e dhunës në familje, veçanërisht në zonën rurale. Fushatat e informimit të ndërmarra nga sistemi arsimor tejet të rëndësishme, por ato duhet të jenë të koordinuara nga bashkia dhe të përfshijnë të gjithë aktorët që janë pjesë e mekanizmit për adresimin e dhunës (bashki, polici, shëndetësi, shërbime sociale, etj) me qëllim që arrijnë ndikimin e duhur. Edhe nëse nuk ka burime financiare për të ofruar shërbime rehabilituese dhe emergjente për viktimat e dhunës në familje, bashkia duhet të ndërveprojë me qarkun apo aktorë të tjerë kombëtarë me qëllim garantimin e shërbimeve të nevojshme për këtë grup.
- Në këndvështrimin e shërbimeve sociale rekomandojmë përgatitjen e Planit Social të Bashkisë, një plan që duhet të mbaj në konsideratë grupet dhe individët në nevojë, nevojat e tyre për shërbime dhe të parashikoj shërbimet që duhet të ngrihen, bashkë me kostimin e këtyre shërbimeve.
- I nevojshëm informimi i komunitetit në të gjithë territorin e bashkisë dhe në mënyrë të veçantë të komuniteteve rom, egjiptian, personave me aftësi të kufizuara, etj, në lidhje me çështjet e diskriminimit dhe të instrumenteve ligjore që i mbrojnë nga diskriminimi.

# RRETH QENDRËS ALEANCA GJINORE PËR ZHVILLIM

E themeluar në vitin 1994, Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim (GADC) është një organizatë jo fitimprurëse, jo partiake, me mbi 20 vjet eksperiencë në punë kërkimore, edukim publik, asistencë për zhvillim kapacitetesh, monitorim dhe avokim. GADC promovon zhvillimin demokratik dhe mirëqeverisjen me një fokus të veçantë në çështjet e barazisë gjinore dhe përfshirjes sociale. GADC është një organizatë lider në Shqipëri dhe në rajon, e mirënjohur për rolin e saj në prezantimin e çështjeve të rëndësishme në lidhje me të drejtat e grave, siç është dhuna me bazë gjinore dhe trafikimi i personave.

GADC është e njohur për zhvillimin e metodologjive të ndryshme për fuqizimin përmes zhvillimit ekonomik të grupeve vulnerabël, avokimit për çështje themelore ligjore e politika të rëndësishme siç janë Ligji “Për dhunën në marrëdhëniet familjare” apo “Ligji kundër diskriminimit”, Barazia Gjinore apo përfaqësimi i grave në politikë e vendim marrje. Prezantimi i çështjeve të buxhetimit gjinor në nivel lokal dhe qendror si dhe përfshirja e qytetarëve në vendimmarrje janë dy çështje për cilat GADC ka zhvilluar e zbatuar metodologji të veçanta të cilat sollën ndryshime të rëndësishme që adresojnë pabarazitë dhe përfshirjen sociale të grupeve vulnerabël në Shqipëri.

Që nga fillimi GADC ka zbatuar shumë projekte, të cilat kanë ndikuar në jetët e qindra pjesëmarrësve në aktivitetet e zhvilluara në të gjithë Shqipërinë. GADC ka një historik të gjatë bashkëpunimi të suksesshëm me aktorë të ndryshëm, përfshirë një numër të madh organizatash shqiptare, institucionesh publike në nivel qendror e lokal, rajonal dhe ndërkombëtar, sektorit privat, medias, akademisë etj. Disa nga aktorët kyç partnerë të GADC-së janë UN Women, UNDP, BE, Ambasada e SHBA, USAID, OSBE, Dhoma të Tregtisë, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, bashki të ndryshme etj.

GADC fuqizohet në punën e saj nga rrjeti i gjerë i bashkëpunëtorëve, ekspertëve dhe trajnerëve kombëtarë e ndërkombëtarë me formim të pasur akademik. GADC punon të shpërndajë sa më shumë informacion dhe të kthehet në një platformë për ndarje eksperiencash e njohurie me të gjithë e në të gjithë vendin.



VLERËSIMI I KOMUNITETIT PËR QEVERISJEN

RAPORT BASHKIA KUÇOVË